



Tradita gojore pas ungjijve- Pjesa e I

Description

Bart Ehrman

Për momentin, do ta lëmë mënjanë çështjen e autorësisë së ungjijve, përveç për të theksuar faktin se të katër ungjijtë janë vepra anonime, autorët nuk na e kanë lënë të shkruar identitetin e tyre. Preokupimi ynë hëpërhë përfshin një tjetër çështje, d.m.th. si dhe kur këto autorë anonim i kanë huazuar historitë e tyre lidhur me Jezusin. Në këtë rast kemi favorin, të kemi informacion të drejtpërdrejt së paku për një nga këta autorë i cili ka prekur këtë çështje. Luka (ne nuk e dimë emrin e tij të vërtetë) e fillon ungjillin e tij duke përmendur rrëfime të hershme të jetës së Jezusit dhe duke treguar se ai si edhe pararendësit e tij i kanë siguruar këto të dhëna nga të krishterë të ndryshëm të cilët kanë rrëfyer histori rreth Jezusit (Luka 1:1-4). Që do të thotë se këto shkrime janë mbështetur në traditën gojore, histori që kanë qarkulluar që nga momenti që Jezusi ka vdekur deri në momentin kur ungjillorët kanë shkruar ungjijtë e tyre. Sa i gjatë, saktësisht, ka qenë ky interval?

Asnjë nuk e di me siguri se kur ka vdekur Jezusi, por teologët kanë rënë dakord se ajo ka ndodhur rreth vitit 30 e.r. Për më tepër, shumica e historianëve mendojnë se Marku është i pari prej ungjijve kanonik që është shkruar, diku në fund të viteve 60 fillim viteve 70 e.r. Mateu dhe Luka janë shkruar dikur rreth 10 ose 15 vjet më vonë, me shumë mundësi rreth viteve 80-85. Po ashtu edhe Gjoni duket se është shkruar rreth 10 vjet më vonë, në vitet 90-95. Këto padyshim që janë vlerësime të përafërta por shumica e teologëve pajtohen me këto të dhëna, ku më shumë e ku më pak.

Ndoshta gjëja më çuditshme për teologët në lidhje me këto data, është intervali i gjatë kohorë ndërmjet vdekjes së Jezusit dhe rrëfimeve më të hershme për jetën e tij. Rrëfimet tona të para për jetën e Jezusit (d.m.th. ungjijtë) duket se datojnë nga 35 deri në 65 vjet pas këtij fakti. Kjo mund të mos duket një kohë e gjatë, por të përpqemi të mendojmë për të në kohët tona. Nëse marrim intervalin më të afërt (hapësira ndërmjet Jezusit dhe Markut), do të ishte njësoj sikur lajmi i parë i shkruar për presidencën e Lyndon Johnson të shfaqej sot. Po të marrim intervalin më të gjatë kohorë (midis Jezusit dhe Gjonit), do të ishte njësoj sikur predikimet e një predikuesi të njohur të luftës së dytë botërore të shfaqeshin me shkrim vetëm në ditët tona. Ne nuk duhet të mendojmë se rrëfimet e ungjijve janë domosdoshmërisht të gënjeshtërt vetëm sepse ato janë të vonshme. Por këto të dhëna duhet të na

bëjnë të mendojmë për një moment. Çfarë ka ndodhur gjatë këtyre tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë vjetëve midis vdekjes së Jezusit dhe shkrimeve të Ungjijve?

Padyshim, gjëja më e rëndësishme që i ka ndodhur krishterimit të hershëm në këtë kohë është përhapja e kësaj feje nga një fillim jo dhe aq premtues si një sekt i brishtë të krishterësh hebrenjt brenda Judaizmit-ungjijtë rrëfejnë se ishin vetëm njëmbëdhjetë burra dhe disa gra të cilët i qëndruan besnik atij pas kryqëzimit, le të themi një total prej 15 apo 20 njerëzve gjithsej- në ngritjen e statusit të saj në një religjion botërorë mbështetur energjikisht nga besimtarë të krishterë në zonat më të mëdha urbane përgjatë gjithë perandorisë romake. Misionarë si Pali në mënyrë aktive e përhapën këtë fe, duke konvertuar hebrenj dhe xhentil në besimin e Krishtit si Biri i Perëndisë, i cili ishte kryqëzuar për mëkatet e kësaj bote e më pas ishte ngritur nga Perëndia prej së vdekuri.

Në fund të shekullit të parë, ky grup i brishtë dishepujsh të Jezusit, ishte shumëfishuar kaq shumë saqë kishte grupe besimtarësh në qytete të tilla si Judea, Samaria, Galilea, me shumë mundësi edhe në anën lindore të lumit Jordan; në Siri, Cilicia dhe Azia e vogël, në Maqedoni dhe Akaia, (greqia e sotme), në Itali dhe ndoshta në Spanjë. Në këtë kohë krishterimi mund të jetë përhapur në Mesdheun jugor, ndoshta në Egjipt dhe ndoshta edhe në Afrikën Veriore.

Sigurisht, të krishterët nuk e zotëruan botën përmes dhunës. Zyrtarët romak të provincave duket se nuk e njihnin fenomenin e të krishterëve së paku deri në shekullin e dytë të shekullit të parë. Çuditërisht nuk ka asnjë të dhënë për Jezusin apo ndjekësit e tij në literaturën pagane apo të çfarëdolloji gjatë shekullit të parë. Megjithatë feja e krishterë, qetësisht dhe vazhdimisht zgjerohej, jo duke konvertuar miliona njerëz, por sigurisht së paku mijëra prej tyre, përgjatë krejt Mesdheut.

Çfarë i kanë thënë krishterët njerëzve, në atë kohë, për ti bindur që të konvertoheshin? Të dhënat për këtë çështje janë irritueshëm të hapërdara: shembuj të predikimeve misionare në librin e Veprave dhe disa aluzione të Palit në letrat e tij (shih. 1 Thesalonikasve 1:9-10). Ne nuk mund ta dimë me siguri se sa përfaqësuese janë ato. Mbi të gjitha, ka arsye të mjaftueshme për të besuar se shumica e misionit të krishterë është zhvilluar jo përmes predikimeve nëpër sheshe, por privatisht, si individë të cilët kanë besuar se Jezusi është Biri i Perëndisë që i njoftojnë të tjerët për fenë e tyre të re e përpiqen ti bindnin ato për ta përvetësuar atë.

Meqenëse, në botën greko-romake, religjioni shihej si mënyra për të siguruar favorin e perëndive, ne nuk jemi shumë larg sikur të mendojmë se nëse feja e Jezusit është parë si e aftë të prodhojë dobishmëri dhe rezultate të mrekullueshme, atëherë njerëzit ndoshta do të bindeshin të konvertoheshin në të. P.sh., nëse një i krishterë dëshmonte se lutja ndaj Jezusit, apo përmes Jezusit Perëndisë, kishte shëruar vajzën e tij, apo se një besimtarë në Jezusin kishte hequr një shpirt të keq, apo se Zoti i Jezusit kishte pajisur me ushqim një familje në skamje, kjo ndoshta mund të ketë ngjallur interesin e fqinjëve të tij apo kolegëve të punës. Ato të cilët shfaqnin interes për Jezusin do kenë dëshiruar të dinë më shumë për të. Kush ishte ai? Ku ka jetuar ai? Çfarë ka bërë ai? Si vdiq ai? Të krishterët si rrjedhojë kanë qenë të detyruar dhe të gatshëm ti tregonin histori rreth Jezusit kujtdo që ishte i interesuar.

Këto mundësi për të treguar histori në lidhje me Jezusin duhet të kenë ndodhur përgjatë gjithë zonave të mëdha urbane të Mesdheut për dekada me radhë para se të shkruheshin ungjijtë. Përndryshe nuk do të kishte asnjë mënyrë tjetër për të shpjeguar përhapjen e një feje gjatë një kohë e cila nuk gëzonte begatinë e telekomunikacionit. Kur njerëzit të kishin dëgjuar mjaftueshëm (sadoqë të ketë qenë ajo) atëherë mund të kenë vendosur për të besuar në Jezusin. Ky veprim, ndër të tjera, ka bërë të

detyrueshëm përvetësimin e disa aspekteve religjioze të krishterimit, që për johebrenjtë nënkuptonte pranimin e Zotit hebre dhe braktisjen e zotave të tyre, meqenëse hebrenjtë pohonin se vetëm ky Zot ishte i vërteti. Pasi i konvertuari të kishte ndërmarrë këtë hap, atëherë ai bashkohej me bashkësinë duke u pagëzuar dhe duke marrë një mësim të krishterë bazë. Me shumë mundësi kanë qenë liderët e bashkësisë atë që kanë kryer pagëzimin dhe mësimdhënien. Këto njerëz me shumë mundësi kanë qenë besimtarët më të hershëm të bashkësisë në atë zonë ose njerëz me dhunti të veçanta udhëheqjeje, me shumë gjasa më të diturit e bashkësisë që shiheshin edhe si më të përshtatshmit të për të kryer mësimdhënien. Nuk e dimë me saktësi se çfarë i kanë mësuar liderët të sapokonvertuarve, por ne mund të imagjinojmë se ato i kanë predikuar disa aspekte thelbësore të besimit të ri: informacion lidhur me Zotin e vetëm dhe të vërtetë, rreth krijimit të tij, dhe rreth birit Jezus. Deri në një farë mase kjo gjë ka kërkuar rrëfimin e historive të mëtejshme lidhur me atë se kush ishte Jezusi, rreth mënyrës se si ai kishte ardhur në këtë botë, rreth asaj që ai predikoi, asaj që bëri, përse vuajti dhe përse vdiq. Historitë lidhur me Jezusin, pra, janë treguar përgjatë Mesdheut për dekada me radhë, si për të tërhequr njerëz në besim ashtu edhe për të forcuar ata të cilët tashëm ishin besimtarë. Ato kanë qenë rrëfyer në evangjelizim, në predikim, e ndoshta edhe në shërbesat e adhurimit. Historitë, detyrimisht, kanë kaluar nga njeri tek tjetri gojarisht, sepse siç e thamë ungjijtë në këtë kohë nuk ishin shkruar ende. Kush atëherë i tregonte historitë?

Fatkeqësisht ne nuk e njohim identitetin e saktë të atyre që ishin përgjegjës për përçimin e historive lidhur me Jezusin. A mos ndoshta çdo histori është treguar nga një apostull? E pamundur. Ato duhet të kenë qenë treguar nga njerëz të cilët në pjesën më të madhe nuk kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve, të cilët kanë dëgjuar nga njerëz të tjerë, që gjithashtu as ata nuk kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve. Historitë kanë kaluar gojarisht nga një i konvertuar tek tjetri. Ato janë rrëfyer në shtete të ndryshme, në Egjipt, Galile, Siri, dhe Cicili, përgjatë Azisë së vogël, Maqedonisë, Greqisë, Italisë dhe Spanjës. Ato janë rrëfyer në kontekste të ndryshme, për arsye të ndryshme, në vende të ndryshme. Ato janë rrëfyer në një gjuhë të ndryshme nga ajo e Jezusit (ai fliste aramaikisht, ndërsa shumica e të konvertuarve greqisht), shpesh nga njerëz që nuk ishin hebrenj, pothuajse gjithnjë nga njerëz që nuk kishin qenë dëshmitarë të historive që rrëfenin e që nuk kishin takuar asnjëherë një të tillë. Lërmëni ta ilustroni këtë proces përmes një shembulli hipotetik. Le të supozojmë se unë jam një greqisht folës adhures i perëndeshës Artemis nga Efezi. Rastësisht dëgjoj për një të huaj që qarkullon nëpër qytet duke rrëfyer për veprat çudibërëse të Jezusit, për mrekullitë dhe urtësinë e mbinatyrshme të tij. Kjo më ngjall kureshtje. Kur dëgjoj që ky i huaj bën mrekulli në emër të Jezusit-djali i fqinjët tim ishte i sëmure por dy ditë pasi ky i huaj u lut për të ai u shërua- vendos ta shqyrtoj më në hollësi këtë çështje. Ai rrëfen se si Jezusi kryente mrekullitë dhe se si, i dënuar me kryqëzim padrejtësisht nga romakët për rebelim, ai ishte ngritur nga Perëndia prej së vdekuri. Duke u mbështetur në gjithë këtë që kam dëgjuar unë vendos të heqë dorë nga devocioni im ndaj perëndeshës Artemis. Vendos të besoj në Jezusin, pagëzohem dhe bashkohem me bashkësinë e besimtarëve. Unë ndërmarr një udhëtimin në qytetin fqinj Smirna. Atje i rrëfej një miku për fenë e re që kam përqaftuar si dhe historitë në lidhje me Zotin tim të ri. Tre prej tyre vendosin të më ndjekin në këtë vendim. Ato vendosin të diskutojnë rreth këtyre gjërave me fqinjët dhe miqtë e tyre. Shumë prej tyre nuk pranojnë të konvertohen, por mjaftueshëm prej tyre vendosin të jenë pjesë e kësaj feje te re, aq sa një here në javë të mblidhen për adhurime, për të diskutuar fenë e tyre të re si edhe për të treguar akoma më shumë histori. Këto të sapokonvertuar i rrëfejnë familjeve të tyre për këtë çështje duke konvertuar disa prej tyre, gjë që e dërgon fjalën gjithnjë e më larg. E kështu vazhdon më tej. Të konvertuarit vazhdojnë të tregojnë historitë, feja rritet, e shumica e atyre të cilët i tregojnë këto histori nuk janë dëshmitarë të ngjarjeve që rrëfejnë. Në të vërtetë ato nuk i kanë hedhur ndonjëherë as sytë ndonjë dëshmitari të këtyre historive.

Ky shembull nuk do të thotë që saherë që ne kemi një dëshmi nga një dëshmitarë okularë ajo dëshmi është domosdoshmërisht e vërtetë. Madje edhe dëshmitë e dëshmitarëve okularë shpeshherë nuk përputhen. Por skenari që sapo paraqita na ndihmon të kuptojmë arsyen pas kaq shumë dallimeve lidhur me historitë e Jezusit në vitet e para të krishterimi. Këto histori kanë qarkulluar vite e vite e vite me radhë kryesisht nga njerëz që kanë besuar gjatë gjithë jetës se zotat herë pas here kanë qenë të pranishëm në tokë, të cilët njihnin histori rreth disa njerëzve mrekullibërës, që dukej se vepronin në dobi të racës njerëzore, që kishin dëgjuar në vetë të parë për historitë fantastike në lidhje me këtë njeri të shenjtë hebre, Jezusin, që përpiqeshin të konvertonin të tjerët në fe apo të forconin ato që ishin tashmë besimtarë. Mbi të gjitha, pothuajse shumica e këtyre tregimtarëve nuk kanë pasur dije të mirëfilltë e të pavarur për atë që me të vërtetë kishte ndodhur. *Jua lë ju ta imagjinoni se çfarë mund ti ketë ngjarë këtyre historive.*

Ju ndoshta jeni të mirënjohur me lojën e vjetër të “telefonit të prishur”. Një grup fëmijësh ulën në rreth, i pari i tregon një histori të shkurtër një tjetri i ulur përbi tij, i cili ia tregon këtë një tjetri, e një tjetri, e një tjetri e kështu me radhë, derisa radha vjen deri tek ai që e kishte filluar. Natyrisht historia ka ndryshuar kaq shumë gjatë transmetimit sa që çdokush fillon të qeshë (nëse nuk do të funksiononte kështu përse do të luhej atëherë). Imagjino sikur i njëjti aktivitet të kryhet, jo në një dhomë ku janë mbledhur disa fëmijë për të kaluar një drekë, por përgjatë gjithë perandorisë romake (rreth 2.500 milje mes për mes), me mijëra pjesëmarrës, nga mjedise të ndryshme, me preokupime të ndryshme, në kontekste të ndryshme, disa prej tyre të detyruar ti përkthejnë historitë në gjuhë të ndryshme.

Gjendja, në fakt, është më e ndërlikuar se kaq. Njerëzit në bashkësitë e krishtera që u përhapën kudo përgjatë Mesdheut, ngjashëm si njerëzit në çdo vend tjetër ndeshnin shumë vështirësi gjatë jetës së tyre të përditshme dhe kërkonin ndihmë dhe udhëzim prej së larti. Traditat lidhur me Jezusin ishin themeli i këtyre bashkësive; veprimet e tij ishin një model për tu ndjekur nga të krishterët, fjalët e tij ishin mësim të cilave ata i bindeshin. Duke pasur parasysh këtë është a është e mundur që të krishterët të kenë krijuar një histori që të ishte e dobishme në një situatë të veçantë? Të krijosh një histori nuk është shumë e ndryshme nga të ndryshuarit e njëjës prej tyre, e me shumë mundësi njerëzit kanë parë më shumë se një arsye për ti bërë të dyja.

Të krishterët nuk kishin nevojë të ishin mashtrues dhe të ligë për të shpikur një histori lidhur me diçka që Jezusi kish bërë apo thënë. Ato nuk kishin nevojë as të ishin të ndërgjegjshëm për këtë. Të gjitha historitë rreth njerëzve janë krijuar pa një qëllim të ligë pas tyre, e ndonjëherë historitë tregohen në lidhje me njerëz që ne i njohim e ne e dimë se ato nuk janë të sakta: pyet për këtë çdo person që përflitet shumë, politikan, lider fetar, apo një profesor universiteti.

[*] Bart Ehrman është James A. Gray professor dhe shef i departamentit për studimet fetare në Universitetin e Karolinës së Veriut në Chapel Hill. Ai konsiderohet një prej figurave më të rëndësishme në disiplinën e kritikës tekstuale dhe të krishterimit të hershëm. Bart Ehrman është gjithashtu edhe autor i shumë librave ndër të cilat vlen të përmendim: “Lost Christianities: The Battle for Faith and Scripture we Never Knew (OUP) 2003; Lost Scripture: Book That Did Not Make It into The New Testament (OUP) 2003); The New Testament: A Historical Introduction to the New Testament Writings (OUP) 2003 etj.

Përktheu: Rezart Beka

Fragment i shkëputur nga libri i autorit Bart Ehrman me titull: "A Brief Introduction to the New Testament"; Oxford University Press, USA (February 19, 2004)

Date Created

14/01/2013

Author

erasmusi